



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 27 shtator 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni – kryetar, Gani Geci, Bajram Kosumi, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha, Adem Hajdaraj, Radmila Vujoviq dhe Mufera Şinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Sanije Berish – OSBE, Isuf Zejna – KDI, Ehat Miftaraj – MD, Mentor Borovci – AKK, Jetullah Aliu – AKK, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës,
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit,
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 03/3986/L-230, për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM),
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 03/L-184 për energjinë,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që si pika të rendit të ditës të hyjnë edhe shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për mbrojtjen e natyrës dhe shqyrtimi i kërkesës së Behxhet Pacollit për interpretim të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, lidhur me publikimin ose jo të formularit për deklarimin e pasurisë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës,

Kryetari paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet për P/L për aspektet civile, duke shtuar se ky P/L është i hartuar mirë, prandaj edhe grupi i punës nuk ka pasur shumë punë dhe ka bërë vetëm pesë amendamente, dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e grupit të punës në P/L për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës dhe të njëjtat procedohen për shqyrtim të mëtejme në Komisionet kryesore.

Amendamenti 1

Neni 8 riformulohet si vijon: “ Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i urdhërave dhe aktvendimeve sipas këtij ligji do të procedohen në pajtim me Ligjin e Procedurës Jokontestimore. “

Neni 8, paragrafi 5 hiqet dhe radhitja do të bëhet sipas numrave me radhë.

Neni 8, paragrafi 7 riformulohet si vijon: “ Procedurat gjyqësore do të procedohen në pajtim me Ligjin e Procedurës Jokontestimore, nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë ligj. “

Neni 8, paragrafët 8 dhe 9 hiqen dhe radhitja do të bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 2

Neni 18, në rreshtin e gjashtë fjalët: “, ose kur kjo nuk është e mundur, në përkthim në gjuhën angleze.” Hiqen.

Amendamenti 3

Neni 19, paragrafi 2 riformulohet si vijon:” Ndiurma ligjore do t’i vihet në dispozicion kërkuar dhe përgjegjësit për të mbuluar shpenzimet e përfaqësimit ligjor në bazë të kërkesës.”

Amendamenti 4

Neni 21 riformulohet si vijon:” Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.”

Amendamenti 5

Shtohet neni 22 me titull dhe përmbajtje si vijon: “ Dispozitat Kalimtare “, “ Deri me hyrjen në fuqi të ligjit për gjykatat, gjykatë kompetente për zbatimin e këtij ligji do të jetë Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Me hyrjen në fuqi të ligjit për gjykatat, gjykatë kompetente për zbatimin e këtij ligji do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë”, kurse neni 22 i ligjit bëhet neni 23 dhe radhitja do të bëhet sipas numrave me radhë.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit

Kryetari paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet në P/L për dokumentet e udhëtimit, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL dhe kërkoi nga anëtarët që nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente t’i paraqesin në mënyrë që ato të përfshihen në raport që do t’i dërgohen Komisionit FunkSIONAL.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 03/3986/L-230, për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)

Kryetari paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet në P/L për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 03/L-184 për energjinë

Kryetari paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet në P/L për energjinë, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji për energjinë nr. 03/L-184 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme.

A. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për mbrojtjen e natyrës.

Selvije Halimi - Paraqiti arsyetimin për amendamentet në P/L për mbrojtjen e natyrës, si anëtare e atij Komisioni, duke shtuar se diskutuese në këtë projektligj ka qenë pjesa që ka të bëjë me koncesionet dhe se e kanë bërë harmonizimin me atë ligj. Prandaj kërkoi që të njëjtat të përkrahen, sepse është nga ligjet që duhet të miratohen deri më 30 shtator 2010.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 03/4197/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

B. Shqyrtimi i kërkesës së Behxhet Pacollit

Kryetari- Tha se kemi marrë kërkesën e Behxhet Pacollit, drejtuar fillimisht Agjencisë Kundër Korrupsionit për interpretim të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, lidhur me publikimin ose jo të formularit për deklarimin e

pasurisë, dhe e njëjta është përcjellë në Komision nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Lidhur me këtë pika hapi debat.

Ibrahim Makolli - Tha se ky komision nuk është kompetent ta interpretojë ligjin, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, sepse ajo duhet ta interpretojë dhe jo Kuvendi ose komisionet e Kuvendit. Ai tha se unë abstenoj edhe nga diskutimi edhe nga votimi, jo pse bëhet fjalë për liderin e AAK- së por për faktin se Komisioni nuk është i thirrur ta interpretojë ligjin. Në njërën anë kemi ligjin për deklarimin e pasurisë, që na obligon ta deklarojmë pasurinë dhe në anën tjetër kemi ligje që sigurojnë të drejtën e privatësisë. Andaj në këtë raport i vetmi autoritet që mund ta thotë fjalën e fundit është Gjykata Kushtetuese.

Kryetari- Në fjalën e tij të serishme tha nuk është qëllimi as i Agjencisë që të japin në interpretim të drejtpërdrejtë, por për faktin se jemi Komision Parlamentar që e mbikëqyrim punën e Agjencisë, prandaj edhe ka kërkuar nga Komisioni sugjerim për veprimet e më tutjeshme. Ai tha se çështja është e ndërlikuar, sepse edhe kur është shqyrtuar ligji kemi qenë të vetëdijshëm se do të vijmë në këto situata. Kërkesa nuk do të duhej t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, sepse këtu nuk ka kontest, sepse Behxhet Pacolli e ka deklaruar pasurinë, por nuk dëshiron që ajo të publikohet. Andaj lidhur me këtë ndoshta do të duhej ta mbajë një takim konsultativ me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese që të marrë sqarime shtesë. Lidhur me këtë kërkoi sqarime nga përfaqësuesit e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me këtë çështje.

Mentor Berovci- Tha se është i pari rast i Agjencisë në aspektin e deklarimit të pasurisë dhe si duket është edhe ligji që ka lenë vend për interpretim të dyanëshëm. Ai ju referua nenit 12 të ligjit duke dhënë sqarime se ky ligj lejon interpretime që publikimi të bëhet dhe sipas ligjit për qasjen në dokumentet zyrtare, që kërkon pëlqimin e autorit dhe ligjit për deklarimin e pasurisë që deklarimi të bëhet në internet-faqe. Në vazhdim tha se z. Behgjet Pacolli vazhdimisht e ka deklaruar pasurinë, por me hyrjen në fuqi të këtij ligji është krijuar kjo situatë. Po ashtu ai thirret edhe në faktin se pasuria e tij është krijuar jashtë vendit edhe kjo e komplikon edhe më shumë çështjen që të kemi konflikte ligjesh.

Gani Geci - Duke u ndërlidhur me diskutimet e para folësve tha se kërkesa e Behxhet Pacollit është e arsyetuar drejt, sepse publikimi i pasurisë së tij paraqet rrezik për të dhe familjen e tij. Ai mori shembuj lidhur me situatat të tilla nëse behët publike pasuria e një individi, siç është ajo e Behxhet Pacollit, paraqesin rrezik për ta dhe familjen e tyre, ngase shumica e pasurisë së tij nuk është e krijuar në Kosovë. Dhe në fund tha se publikimi i pasurisë në shume vende në internet - faqe është shkelje e të drejtave të njeriut.

Armend Zemaj- Tha se në kohën kur është shqyrtuar ky ligj në Komision ka pasur mendime të arsyeshme për mos publikim të pasurisë, sepse gjithë ajo çka po bisedohet sot, ne i kemi thënë atëherë ngase e kemi ditur se do të vijmë në këtë situatë. Z. Behxhet Pacolli e ka deklaruar pasurinë, por në anën tjetër i është dhënë mundësia që ta tërheqë formularin dhe mund të dënohet në Gjykatën për Kundërvajtje për mos deklarim të pasurisë. Në vazhdim shtoi se nëse krijojmë precedent që të mos deklarohet pasuria atëherë shumica deputeteve nuk do ta deklarojnë pasurinë. Ne, si Komision, mund të marrim iniciativë që ta shikojmë implementimin e ligjit dhe nëse është nevoja edhe plotësim ndryshimin e tij.

Selviqe Halimi- Tha se në rastin konkret ligj parësor është ligji për deklarimin e pasurisë, edhe pse ka qenë shumë diskutuese çështja e deklarimit të pasurisë në emër të transparencës kemi venduar ashtu siç është në ligj. Nëse marrim obligim si Komision të japim interpretim, ne po i japim vetës një barrë ashtu siç i kemi dhënë kur e kemi shqyrtuar këtë ligj, sepse po i vejmë në rrezik në njërin anë dhe në anën tjetër ndeshja me ligjet e tjera që ai është thirrur personi në fjalë.

Adem Hajdaraj- Tha se ne nuk duhet të merremi me këtë çështje, kur ne vetë e kemi nxjerrë ligjin, kurse Agjencia është ajo që duhet ta zbatojë ligjin, nëse është e nevojshme ajo le t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ai tha se nuk duhet të krijohen praktika të tilla, sepse ka edhe zyrtarë të tjerë që mund të jenë të rrezikuar në këtë formë dhe ne nuk duhet të bëjmë lëshime.

Bajram Kosumi- Tha se edhe kur është shqyrtuar ligji kam pasur mendimin tim se është e padrejtë të publikohet. Prandaj lidhur me këtë nuk do të duhej të merren veprime të ngutshme, sepse është një ligj të cilin e kemi votuar. Ishte i mendimit që Gjykata Kushtetuese nuk ka objekt që ta trajtojë këtë çështje kështu siç është, objekt gjykata do të kishte nëse e kërkojmë ne, p.sh., neni që thotë: “ duhet të publikohet “ të shikohet se a është në përputhje me kushtetutën dhe me normat ndërkombëtare.

Lidhur me këtë çështje Komisioni nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni u pajtua që rreth kësaj çështje të zhvillohen konsultime shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni